

VENDIM
Nr. 186, datë 26.2.2020

**PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE
INDIVIDUALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “iii”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për rindërtimin, sipas projekteve model, të shtëpive individuale të dëmtuara nga tërmeti, jashtë zonave të reja të shpallura në bashkitë: Durrës, Kamzë, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak dhe Vorë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për rindërtimin, sipas projekteve model, të shtëpive individuale të dëmtuara nga tërmeti, jashtë zonave të reja të shpallura në Bashkinë Tiranë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe